



Si të zbulojmë **talentet** e fëmijëve

Intervistë me **William Maxwell**, psikolog i specializuar për prindërimin në Harvard University



William Maxwell fitoi titullin B.S në edukim - Shkencat fizike - Në Universitetin Oregon State, gradën Ed. M dhe Ed.D në Harvard. Ka studiuar gjithashtu në universitetin e Maryland, Kaliforni, dhe Oxford. Studimet e tij kërkimore për inteligjencën janë publikuar në "Raportet Psikologjike", "Phi Delta Kappan", "Gazeta Ndërkombëtare e Zhvillimit të Edukimit", "Lidershipi Edukativ" dhe të tjera. Libri i tij, "Thinking: Frontiera në zgjerim", ndodhet në listën e rekomandimeve për lexime mbi të menduarit në "Graduate School of Education". Dr.Maxwell ka qenë "koka" e edukimit të mësuesve në katër universitete, duke përfshirë Universitetin e Paqësorit të Jugut, Suva, Fiji etj. Aktualisht është profesor në Universitetin e New York-ut në Tiranë dhe ka ndërmarrë një iniciativë në ndihmë të fëmijëve shqiptarë. Na ndiqni në këtë intervistë me të.



William Maxwell
Psikolog i specializuar për prindërimin, USA

Cila ishte arsyeja që ju vendosët të vini dhe të jepni përvojën tuaj në Shqipëri.

Apo ishte zgjedhje e rastësishme?

Deri diku po, ishte e rastësishme, por jo tërësisht. Shqipëria është një vend i cili nuk ka një medalje olimpike. Kisha dëgjuar që ideja e një territori olimpik akademik do mund të pranohej këtu, ndaj dhe vendosa të ndërmarr këtë iniciativë duke prezantuar idenë e zhvillimit të një akademie globale, e cila do trajnojë fëmijë nga vende që nuk mund të përballojnë një shkollë olimpike të cilësisë së parë.

Për shembull, në SHBA është një shkollë olimpike dhe qëllimi i saj është që të përgatiten fëmijët për lojërat olimpike por pagesa është 200 000 \$ për person në vit. Pra, është një shpenzim shumë i madh.

Si po ia dilni ta realizoni këtë në Shqipëri?

Po përpiqem të bëj progres këtu në Shqipëri. Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve na ka mbështetur. Komiteti nacional olimpik i Shqipërisë na ka mbështetur gjithashtu dhe tani ne kemi një avokat me



Shikoni botën sot, ne jemi 224 shtete. Më shumë se gjysma e këtyre shteteve, udhëhiqen nga njerëz të paaftë. Sepse popullata nuk është e trajnuar sesi të zgjedhin liderët

të cilin po punojmë dhe po planifikojmë trajnime për fëmijë nga mosha 8-11 vjeç, duke bashkëpunuar me prindërit apo mësuesit, të cilët mund të evidentojnë tek ata një shkallë të caktuar aftësish olimpike. Ne do të fillojmë nga fundi i gushtit dhe kemi një nga ekspertët më të mirë amerikanë të fitness-it, i cili ka pranuar të vijë. Z. Ian Pyka ishte trajneri i Fitness-it për Skuadrën angleze të futbollit dhe anëtar i Skuadrës Olimpikë në SHBA.

A mendoni se do të jetë e lehtë për të identifikuar fëmijët e talentuar?

Një nga detyrimet psikologjike të rajoneve si Shqipëria dhe 98 vendeve të cilat nuk kanë fituar kurrë një medalje olimpikë, është që njerëzit (mësuesit, edukatorët dhe prindërit) duhet të fillojnë të identifikojnë fëmijët më aftësi të veçanta në një moshë më të hershme.

Cila mendoni se është arsyeja pse prindërit dhe mësuesit fillojnë shumë vonë të identifikojnë këta fëmijë?

Justifikimi tipik i prindërve në Amerikë është: “Ne duam që fëmijët tanë të jenë të lirë”. Liria është një virtut por që të identifikosh edhe aftësitë e një fëmije duhet të inkurajosh fëmijën, për shembull të praktikojë pianon. Ju nuk i kufizoni atij liritë, ju ia zgjeroni ato. Është detyra e prindërve që të identifikojnë sa më herët që të jetë e mundur një talent potencial dhe të inkurajojnë fëmijën që ta zhvillojë atë talent. Për shembull, siç është praktikimi i pianos. Askush nuk mund të bëhet një pianist i mirë pa u ushtruar gjatë. Prindërit, nuk kufizojnë zgjedhjet e fëmijëve të tyre duke insistuar që ai ose ajo të praktikojë pianon. Prindërit në këtë mënyrë, zgjerojnë mundësitë e zgjedhjeve për fëmijët e tyre.

Prindërit shqiptarë janë shumë të kujdesshëm për këtë gjë dhe ajo që vihet re është që ata i mbështesin fëmijët kur identifikojnë talente. Si mundën ata të kuptojnë se fëmijët e tyre janë të talentuar në një drejtim të caktuar?

Howard Gardner, një nga psikologët më të mirë në botë sot, nxori në pah një fenomen të ri i cili nuk është evidentuar ende nga shumë kultura por mendoj se do të evidentohet në vitet e ardhshme: është një pyetje që fëmija e bën shumë herët në jetë: “Cilat janë talentet e mia?”, “Si të zbuloj talentet e mia?”. Sipas Gardner kjo pyetje është emergjente dhe prindër të kujdesshëm i vërejnë këto aftësi dhe pastaj fillojnë të vëzhgojnë fëmijën me shumë kujdes në mënyrë që të trajnohet dhe udhëhiqet. Pra, identifikimi i talentit fillon rreth moshës 2-vjeçare. Për shembull, një prind më thoshte “sa herë që fëmija im luan futboll, dhe sa herë që njëri nga lojtarët dëmtohet, ai vrapon për ta ndihmuar”. Kjo do të thotë se fëmija ka dëshirën dhe tërhiqet nga dhënia e ndihmës së parë e kjo i jep atij orientim nga mjekësia. Fëmijë të tjerë mund të ndërtojnë shumë gjëra të tjera, kështu prindërit shprehen: “Mendoj se fëmija im do të bëhet inxhinier apo arki-tekt, apo diçka e tillë”.

Ajo që vihet re te prindërit shqiptarë është se ata i angazhojnë fëmijët e tyre në kurse të ndryshme por shpesh mendojnë se duke i angazhuar me sport mund të mbeten prapa në mësim. Cili është opinioni juaj?

Ne, qeniet njerëzore udhëhiqemi nga një dëshirë e vetme, por askush në botë nuk ka më një dëshirë të vetme. Është shumë e rëndësishme që të ruajmë balancat dhe të jemi aktivë si në shtëpi dhe jashtë saj, në shkollë, në fushën e lojës etj. Pra, kërkohet të ruhet balanca. Psh. Hobi im për shumë vite ishte të kërkoja për jetën e përditshme të njerëzve shumë inteligjentë ose gjenive. Pra, si ishte jeta e përditshme e gjenive? Jeta e përditshme e gjenive ishte e balancuar, kishte muzikë në shtëpi, kishte gjithnjë lojëra pas darke etj. Pra çdo gjë në jetën e këtyre gjenive ishte e balancuar dhe në ekuilibër. Kështu edhe inteligjenca gjente terren për t'u zhvilluar. Të gjitha llojet e inteligjencave si inteligjenca artistike, matematikore, muzikore etj., janë të balancuara.

Pra, ju doni të thoni që nuk mjafton thjesht të kesh një fëmijë, i cili është i shkëlqyer në matematikë apo shkollë por duhet të t'i inkurajojmë ato që të angazhohen në aktivitete të tjera, pse jo dhe me sport gjithashtu?

Sporti na ndihmon që të mësojmë të punojmë në skuadër dhe të “lexojmë” mendjen e njerëzve të tjerë. Mësimi i teknikave sportive shkon përshtat me mësimin e strategjive që na ndihmojnë për të ndërto-